



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Data 04.07.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM I PROCESIONARES NË BIMËSI”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

90720000-0 Mbrojtja e Mjedisit

VLERA E FONDIT LIMIT.

Fond limit është: **4 158 204 (katër milion e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e katër) lekë pa Tvsh..**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren: 83,164 (tetëdhjetë e tremijë e*

njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”*

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

2.1.2 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 14001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit mjedisor, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO)

2.1.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 45001** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO)

Argumentimi: *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga*

Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Si dhe për vetë natyrën e shërbimit është e rëndësishme Përmbushja kërkesat për zbatimin e standartit për sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë për të menaxhuar: Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë.

2.1.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencat si më poshtë vijon:

- Licencën për shërbime profesionale për zbatime dhe projektme me Kod III.7.A (te vlefshme) Kjo Licencë garanton eksperiencën dhe profesionalizmin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimin.

Argumentimi: Shërbimi përfshin luftohet mekanikisht konform kushteve teknike për të arritur qëllimin kryesor i cili konsiston në asgjësimin e saj. Lufta mekanike konsiston në prerjen dhe asgjësimin e qeskave dhe të degëve të infektuara nga dëmtuesit e procesionares, të cilat gjatë asgjësimit mund të derdhen dhe të shkaktojnë dëmtime të mjedisit dhe florës e faunës përreth objektit i cili po pastrohet nga procesionarja.

Qëllimi i disponimit të kësaj Licence është garantimi i një niveli të lartë mbrojtjeje të mjedisit në përputhje me ligjin. Kjo licensë është e domosdoshme për këtë procedure prokurimi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik dhe është mbështetur dhe në legjislacionin në fuqi sipas ligji “Për Pyjet” nr. 57/2020, neni 30, {pika,1 a}, dhe {pika 2} ku citohet: **pika 1.** Mbrojtja e pyjeve përfshin masat parandaluese, vëzhgimin e situatës në pyje dhe evidentimin e dëmeve apo sinjalizimin e pranisë së faktorëve dëmtues, rikuperimin e dëmeve dhe rehabilitimin e pjesëve të dëmtuara si pasojë e faktorëve dhe fenomeneve, që cenojnë dhe dëmtojnë fondin pyjor kombëtar, të tilla si: prerjet ose kullotja pa leje, dëmtimi i fondit pyjor kombëtar (përfshirë infrastrukturën pyjore dhe veprat ujore), sëmundjet dhe insektet, zjarret, shkatërrimi, pushtimi apo tjetërsimi **dhe pika 2 ku shprehimisht:** Mbrojtja e fondit pyjor kombëtar, pavarësisht nga forma e pronësisë, është detyrë e përhershme e strukturave përgjegjëse për pyjet në nivel qendror dhe vendor, e pronarëve privatë, e subjekteve që kryejnë veprimtari në këtë fond dhe, sipas rastit, edhe e strukturave të tjera shtetërore të ngarkuara nga ligje të tjera.

Sa më sipër me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit.** Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit të karburanteve, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar-Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. *Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;*

b) *Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.*

2. *Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:*

a) *Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;*

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në korrik të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes

vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: 831 641 (tetëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë e një)lekë pa Tvsh .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4,germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **20 (njëzet) punonjës** për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi:

Duke pasur parasysh hapësirat për të cilat duhet të kryhet ky shërbim (101.41 ha) dhe në funksion dhe në zbatim të kërkesave ligjore të Kodit të Punës, operatorët duhet të disponojnë

këtë numër punonjësish si për garantimin e zhvillimit të shërbimit pa ndërprerje ashtu edhe në zbatim të detyrimeve ligjore që kanë të bëjnë në kohën e punës së Punëmarrësve.

Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e shërbimit të objektit të kontratës që kërkohet të zhvillohet. Numri i punonjësve është një element shumë i rëndësishëm për vetë natyrën e shërbimit, pasi natyra e këtij shërbimi objekt kontrate kërkon të ketë staf i cili konsiderohet i nevojshëm për zhvillimin dhe realizimin sa më të sukseshëm të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të punësuar *punonjës të kualifikuar* për realizimin e shërbimit, të pajisur me certifikata trajnimi, minimalisht si më poshtë:

- Punonjës për punime në lartësi 5 (pesë)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Çertifikatat e trajnimit për punonjësit të lëshuara nga organet kompetente.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Stafit teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohet të realizohen të cilat janë shërbime që konsistojnë në prerjen dhe asgjësimin e qeskave dhe të degëve të infektuara (nëse është rasti) nga dëmtuesit e proçesionares të cilat janë punime në lartësi. Gjithashtu ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, dhe llojit të shërbimit që do të kryhet Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", (i ndryshuar).

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, germa (b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Këto kritere janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Njësia e prokurimit gjykon se për realizimin e shërbimit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale,

eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në pasi ka shërbime që do të kryhen nga punonjësit në lartësi .

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 1 (një) Inxhinier Pyjesh vërtetuar me Kontratë pune, Diplomë, liçencë për shërbime profesionale për zbatime dhe projektme dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4(b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) inxhinier pyjesh i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen shërbimeve pasi ai është përgjegjës për zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky inxhinieri është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafin teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen të cilat janë shërbime në fushën e pyjeve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, si dhe në mbështetje të pikës 4 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht: 2(dy) punonjës automakinistë. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi (të vlefshme) të lëshuar.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për realizimin e objektit është kërkuar përdorimi i mjeteve të renda si vinc. Me qëllim administrimin dhe përdorimin e makinerive të rënda për shërbimet që do të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, si dhe disiplinimin e përdorimit të këtyre mjeteve në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kërkohet një staf teknik i specializuar. Gjithashtu për realizimin e objektit janë kërkuar automjetet vinc 2 cope përdorimi i të cilave referon kërkesën për automakiniste të percaktuar nga autoriteti kontraktor. Numri i automakinistëve është kërkuar në përputhje me numrin e mjeteve të renda të kërkuara për realizimin me sukses të objektit. Kriteri është vendosur në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 41, germa (ç) të VKM

Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...”

2.3.7 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike

Operatori ekonomik të ketë në pronësi apo të marra me qera mjetet si më poshtë, të cilat nevojiten për ekzekutimin e kontratës .

Për prerjen e degëve në të cilat janë instaluar qeskat, nevojiten këto mjete të domosdoshme për Operatorin Ekonomik:

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Motorrsekë për krasitje në lartësi	Copë	1	Pronesi/Qera
2	Pajisje për kapjen e degëve në lartësi	Copë	1	Pronesi/Qera
3	Shkallë për ngjitje në lartësi	Copë	5	Pronesi/Qera
4	Gërshërë për prerje të qeskave	Copë	5	Pronesi/Qera
5	Sharrë dore	Copë	5	Pronesi/Qera
6	Cfurkë	Copë	1	Pronesi/Qera
7	Vinç për prerje degësh në lartësi	Copë	2	Pronesi/Qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë në pronësi, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: *dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi)*, certifikata e kontrollit teknik; polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); leje/certifikata e transportit të mallrave për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente;
Për mjetin tip vinç të paraqitet edhe skema e krahut ku të tregohet lartësia mbi 10 m.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, të cilat janë të disponuara me qira, nëse parashikohet nga legjislacioni në fuqi, duhet të paraqitet dokumentacion i vlefshëm si vijon: kontrata e qirasë; leja e qarkullimit; certifikata e kontrollit teknik; polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni); leje/certifikata e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira për mjetet e transportit, lëshuar nga organet kompetente.
Për mjetin tip vinç të paraqitet edhe skema e krahut ku të tregohet lartësia mbi 10 m
- Për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes / akt-zhdoganimi / faturë tatimore / çdo dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi sendin sipas Kodit Civil të RSH. Ndërsa për pajisjet/makineritë/mjetet e tjera të disponuara me qira ose kontratë furnizimi, krahas dokumentacionit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e vlefshme.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga ana e Autoritetit kontraktor.

Shënim: kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE kualifikohet në vend të parë, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për eliminimin e proçesionares nevojitet ndërhyrja mekanike, që konsiston në prerjen e qeskave në të cilat janë të grumbulluara larvat e dëmtuesit dhe më pas, pasi të jenë grumbulluar, të kryhet eliminimi i tyre me anë të djegies. Për prerje dhe eliminimin e tyre nevojiten pajisje teknike të domosdoshme për realizimin e kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 41 pika 4/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion. Për vetë natyrën e procedurës së prokurimit mjetet që duhet të vihen në dispozicion për realizimin në kohë e me efikasitet të kontratës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurrohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike. Specifikimet teknike, për mallrat/shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat/ shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38 dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Specifikimet teknike

Parcela Nr.	Zërat e shërbimeve	Sipërfaqja që do të luftohet dëmtuesi Proçesionarja e Pishës
8/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	12.26
18/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	8.1
18/b	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	12.5

31/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	8.89
17/c	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	23.86
11/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	9.34
12/b	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	4
10/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	5.3
107/a	Luftimi mekanik i proçesionares, në pyje të rritur, infeksioni deri në 40%	17.16
	Totali	101.41 ha

Procesionarja është një sëmundje që luftohet mekanikisht konform kushteve teknike për të arritur qëllimin kryesor i cili konsiston në asgjësimin e saj.

Lufta mekanike konsiston në prerjen dhe asgjësimin e qeskave dhe të degëve të infektuara (nëse është rasti) nga dëmtuesit e proçesionares. Infeksioni është një qeskë e thurur me fije sintetike dhe që vendoset nga dëmtuesi kryesisht në majat e degëve anësore dhe atë të majës (konusit të rritjes). Qeska krijon larvat e dëmtuesit në fillim të Nëntorit deri në fund të Marsit, kohë kur larva pasi kryen stadet jetësore të saj zbret për proçesin e kristalizimit në tokë. Brenda qeskës ndodhen larvat, të cilat në ditët me temperature të ngrohta dalin dhe ushqehen me halat e pishës

Luftimi mekanik kryhet si më poshtë :

- a. Qeska pritët rreth 10-15 cm më poshtë fijeve sintetike, dhe lëshohet në tokë.
- b. Qeskat gumbullohen në një thes apo çarçaf dhe transportohen në vendin e përcaktuar për të kryer djegjen.
- c. Në fund të ditës së punës, në varësi dhe nga numri i qeskave të grumbulluara, behet ekzekutimi i qeskave dhe dëmtuesit brënda tyre, nëpërmjet djegies.
- d. Qeskat e grumbulluara në një vend të hapur (çelëtirë) i cili paracaktohet nga drejtuesi teknik që survejon të gjithë
- e. Gjatë djegies punëtori qëndron afër dhe herë pas here kujdeset që asnjë qeskë të mos mbetet pa u djegur.
- f. Punëtori kujdeset që zjarri të mos përhapet dhe të shkaktojë dëme në parcelë.